



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1138/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Burim Kelmendi, zyrtar ligjor i subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Rivotim për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura më datë 17.12.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Burim Kelmendi, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, me shenjë ZL.Anr.1138/2017, e datës 18.12.2017, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Rivotim për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura më datë 17.12.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1138/2017 me datën 18.12.2017, nga Burim Kelmendi, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, në të cilën pretendon se procesi zgjedhorë në Komunën e Istogut, ka kaluar me parregullsi të shumta. Sipas parashtruesit të ankesës qytetarëve që kanë votuar në zgjedhjet e 17.12.2017 për kryetar të Komunës së Istogut gjatë gjithë procesit të votimit në disa qendra u janë ofruar fletëvotime të shënjuara me laps me ngjyrë, tek emri i kandidatit të LDK-së Haki Rugova ku shihet qartë manipulimi dhe ndikimi tek qytetarët për të votuar kandidatin e LDK-së, me që rast njëri prej qytetareve në qendrën e votimit 0601C/03RC “Haxhi Zeka” në Istog i është dhënë fletëvotimi i tillë. Më tej kanë shtuar se dëshmitare për këtë rast është edhe komisionerja e këtij vendvotimi e cila pas kërkesës së votueses në fjalë asaj i ka dhënë një tjetër fletëvotim mirëpo edhe ka fotografuar fletëvotimin e shënjuar. Sipas parashtruesit të ankesës raste të tilla kanë ndodhur gjatë gjithë procesit të votimit dhe se për këtë kanë dëshmitë e shumë qytetarëve, andaj kërkohet nga PZAP-i që të bëjë hapjen e kutive në qendrën e votimit Haxhi Zeka konkretisht kutinë 0601C/03R, dhe të hetojë të gjitha fletëvotimet.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi dhe deklaratatë të qytetarëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli me qëllim të hetimit, dhe verifikimit të pretendimeve ankimore përkitazi me parregullsitë e fletëvotimeve, me datën 19.12.2017, ka angazhuar ekipin hetues të PZAP-së, për të zhvilluar hetimet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), konform Nenit 14 të Rregullës nr.02/2015 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së, i cili përcakton se ;“ *Kur PZAP-i pranon një ankesë që konsiderohet të jetë e rregullt, dhe kur një ankesë e tillë është e dyshuar për veprimtari mashtruese që përfshin materialin zgjedhor, Paneli vendimmarrës do të autorizoj një anëtar të panelit, si hetues kryesor si dhe zyrtarin ligjor të ngarkuar në çështjen konkrete që ti zhvilloj hetimet*”.


Nga hetimi i bërë nga ekipin hetues i PZAP-së, në kutinë e votimit 0601C/03R, është konstatuar se të gjitha fletëvotimet e rregullta nuk kanë asnjë gabim, pra janë në gjendje të rregullt dhe se përputhen me Formularin për Përputhjen e të dhënave dhe Rezultateve. Në zarfin për fletëvotimet e dëmtuara ka qenë një votë e dëmtuar dhe e njëjta është fotografuar, nga krahasimi i këtij fletëvotimi del se është i njëjti fletëvotim i cili është bashkangjitur në ankesë. Po ashtu në zarfin e fletëvotimeve të pavlefshme kanë qenë katër vota të pavlefshme të njëjtat janë fotografuar. Pas hetimit të bërë është bërë mbyllja e kutisë konform legjislacionit në fuqi. Nga hetimi nuk rezulton që kemi të bëjmë me pa rregullsi zgjedhore, siç pretendohet në ankesë, andaj edhe deklaratimet e dëshmitares znj. Remzije Buleshkaj, të cilës edhe i është ndërruar fletëvotimi pas ankesës, sipas deklaratimit të saj rezulton i vërtetë dhe fletëvotimi është gjetur në zarfin e fletëvotimeve të dëmtuara. Sa i përket deklaratave tjera me shkrim të bashkangjitura të dëshmitarëve, nuk janë marrë parasysh, pasi që nuk kanë të bëjnë me qendrën e votimit 0601C/03R në shkollën Haxhi Zeka në Istog, për të cilin vendvotim kanë të bëjnë pretendimet ankimore.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore vërtetoi se ankuesi nuk arriti që në mënyrë të sigurt dhe bindëse ti vërtetoi pretendimet në ankesë përkitazi me manipulimin e fletëvotimeve. Ndërsa nga hetimi i bërë nga hetuesit e PZAP-së, nuk rezulton se ka pasur fletëvotime të parregullta apo të shënuara siç ka pretenduar pala ankuese.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1138/2017 me datën 19.12.2017.



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën Supreme të Kosovës.